



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 12.06.2019

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9917, DATË 19.5.2008,
“PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË
TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Hyrje

Në bazë të Kalendarit të Punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 5.06.2019, dhe 12.06.2019 mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Alket Hyseni.

Në mbledhjet e Komisionit për të diskutuar dhe paraqitur propozime për projektligjin ishin të pranishëm zëvendës ministri i Financave dhe Ekonomisë z. Elton Haxhi, Drejtori i Përgjithshëm i Drejtësisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave z. Elvis Koçi dhe përfaqësues të kësaj drejtorie.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Nga analiza e nenit 81, pika 2, të Kushtetutës dhe përmbajtjes konkrete të këtij projektligji rezulton se fusha që rregullon ky projektligj nuk përfshihet në çështjet që trajton kjo dispozitë kushtetuese, e për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës.

II. QËLLIMI DHE IMPAKTI I PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i këtij projektligji është mbrojtja e sistemit financiar dhe ekonomisë në tërësi, nga kërcënimet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, duke forcuar integritetin e sistemit parandalues ndaj femonimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit. Nëpërmjet shtesave dhe ndryshimeve të propozuara në ligjin nr. 9917/2018 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar synohet:

- a. përafrimi i plotë i kuadrit ligjor në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (FATF).
- b. zvogëlimi i rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nëpërmjet politikave, koordinimit dhe bashkëpunimit;
- c. parandalimi i hyrjes së produkteve të veprave penale apo veprimtarisë kriminale, si dhe i fondeve në mbështetje të terrorizmit në sektorin financiar apo në sektorë tjerë ose zbulimi dhe raportimi i tyre;
- ç. zbulimi dhe goditja e kërcënimeve për pastrim të parave/ financim terrorizmi, si dhe dënimi dhe heqja e përfitimeve të paligjshme.

Arritja e synimeve të mësipërme realizohet nëpërmjet përafrimit të legjislacionit me rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (*Financial Action Task Force – FATF*). Zbatimi i rekomandimeve të FATF-së, është detyrim që rrjedh nga Konventa e Këshillit të Evropës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.9646, datë 27.11.2006.

Sistemi shqiptar i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i është nënshtruar disa herë vlerësimeve nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës (organi rajonal që vlerëson për vendin tonë përputhshmërinë me rekomandimet e FATF-së). Me qëllim adresimin dhe reflektimin e rekomandimeve të këtij Komiteti janë propozuar dhe miratuar dy amendime të rëndësishme në ligjin 9917/2008 përkatësisht në vitin 2011 dhe 2012.

Gjatë vitit 2018 vendi ynë i është nënshtruar raundit të pestë Vlerësimit për Shqipërinë kryer nga Komiteti Moneyval i Këshillit të Evropës, (raporti i publikuar në datën

05 Korrik 2018). Ky vlerësim ka identifikuar nevojat dhe ka bërë rekomandimet përkatëse në funksion të përputhshmërisë teknike me Rekomandimet e FATF-së.

Shtesa dhe ndryshimet e propozuara nëpërmjet këtij projektligji paraqiten në kuadër të nevojës për reflektimin dhe adresimin e rekomandimeve dhe/ose kritereve përkatëse të rekomandimeve, duke u fokusuar në rekomandimet që janë vlerësuar si të papambushura apo të përmbushura pjesërisht.

III. KONSULTIMI I PROJEKTLIGJIT

Reeruar Raportit të Vlerësimit të Impaktit (RIA) të realizuar për këtë projektligj rezulton se projektligji është konsultuar me bankat e nivelit të dytë, Shoqata e Bankave, shoqëritë e transfertave, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Në datë 27.12.2018 janë realizuar dy takime, një me përfaqësues nga bankat, shoqëritë e transfertave dhe shoqatën e bankave si dhe tjetri me përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, si dhe Autoritetit të Mbikëqyrës Financiare. Në takimet e realizuara janë diskutuar komentet dhe propozimet e më tej janë marrë në konsideratë një pjese e tyre, për aq sa nuk bien ndesh me rekomandimet e FATF dhe qëllimin e ndryshimeve të propozuara.

IV. STANDARTET NDËRKOMBËTARE NË TË CILAT MBËSHTETET NISMA LIGJORE

1. Konventa e Këshillit të Evropës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”.

Neni 13 i Konventës angazhon vendet anëtare që për marrjen e masave legislative dhe masave të tjera të nevojshme për të vendosur një regjim të plotë të brendshëm rregullues dhe mbikëqyrës për të parandaluar pastrimin e parave dhe merr parasysh si duhet standardet e zbatueshme ndërkombëtare, duke përfshirë veçanërisht rekomandimet e miratuara nga Task Force për Veprimin Financiar mbi Pastrimin e Parave (FATF)”.

2. Rekomandimeve Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (FATF)

Rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (*Financial Action Task Force – FATF*), përcaktojnë standardet dhe nxisin zbatimin efektiv të masave ligjore, rregullatore dhe operationale për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe kërcënime të tjera që lidhen me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar. Rekomandimet e FATF përcaktojnë masat thelbësore që vendet anëtare të Këshillit të Evropës duhet të parashikojnë me qëllim:

- a. Identifikimin e rreziqeve, zhvillimin e politikave dhe koordinimin e brendshëm;
- b. Ndjekjen e veprave të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- c. Zbatimin e masave parandaluese për sektorin financiar dhe sektorë të tjerë;
- d. Përcaktimin e kompetencave dhe përgjegjësi të qarta për autoritetet kompetente, ligjzbatuese dhe autoritetet mbikëqyrëse;

- e. Rritja e transparencën dhe disponueshmërinë së informacionit për pronarin përfitues;
- f. Lehtësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar.

3. Gjetjet e Komitetit MONEYVAL

Sistemi shqiptar i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është vlerësuar në kuadër të Raundit të 5-të të vlerësimit për Shqipërinë kryer nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës. Ky vlerësim ka identifikuar nevojat dhe ka bërë rekomandimet përkatëse në funksion të përputhshmërisë teknike me Rekomandimet e FATF-së.

Sipas këtyre rekomandimeve, përpjekjet e vendit janë përqëndruar në sektorët e rregulluar. Të kufizuara janë përpjekjet për vlerësimin dhe zvogëlimin e risqeve të pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit jashtë këtyre sektorëve.

Lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar thuhet se mekanizmi i përgjithshëm për zbatimin e kërkesave për dhënie ndihme juridike është tepër kompleks, ç`ka mund të shkaktojë vonesa, shtuar kjo mungesës së një sistemi prioritizimi të kërkesave të mbërritura.

Për personat juridikë dhe marrëveshjet ligjore mangësi është mungesa e përgjithshme e ndërgjegjësimit lidhur me risqet e mundshme të abuzimit me personat juridikë dhe në vecanti me OJFtë për financimin e terrorizmit e cila është për tu shqetësuar.

Gjithashtu Shqipëria ka mundur të demonstrojë vetëm pjesërisht që masat e sekuestrimit dhe konfiskimit zbatohen efektivisht në raste të pastrimit të parave dhe më gjerë lidhur me veprimtaritë kriminale që sjell produkte.

Lidhur me masat parandaluese dhe sanksionet financiare kundër financimit të terrorizmit nuk është siguruar zbatimi në kohë i Sanksioneve Financiare Specifike.

Mungon legjislacioni për zbatimin e sanksioneve financiare specifike në përputhje me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB lidhur me parandalimin, shtypjen dhe shkatërrimin e përhapjes së armëve të shkatërimit në masë dhe të financimit të tij.

Nëpërmjet ndërhyrjesme anën e këtij projektligji synohet përafrimi me Rekomandimet e FATF që janë detyruese për vendin tonë (më sipër të shpjeguara) dhe nëse nuk realizohet ky përafrim ka mekanizma të ndryshëm shtrëngues që nga monitorimi i përforcuar deri në vendosje të vendit në lista publike. Shkalla e ndërhyrjes nëpërmjet kësaj nisme, synon rritjen dhe saktësimin e detyrimeve kundrejt subjekteve private (banka, institucione financiare, zyra këmbimi valutor etj). Pas ndryshimit të ligjit, do të ndryshojnë aktet nënligjore të cituara më sipër, por jo me ndryshime domethënëse, më shumë me karakter përafrimi me ndryshimet ligjore.

Për gjithë sa më sipër, është vlerësuar se arritja e adresimi i problematikave të listuara realizohet nëpërmjet përafrimit të legjislacionit me rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (*Financial Action Task-Force - FATF*), i cili përcakton standardet si dhe

ndërmerr hapa për nxitjen dhe zbatimin efektiv të masave ligjore, rregullative dhe operacionale për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe kërcënime të tjera që lidhen me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar

V. ÇËSHTJET E DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë prezantimit të projektligjit në Komision propozuesit argumentuan se nëpërmjet ndryshime ligjore të propozuar synohet forcimi i integritetit të sistemit parandalues në vend, siguria në përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare në këtë fushë; zvogëlimi i rreziqeve të financimit të terrorizmit, nëpërmjet politikave të koordinimit dhe bashkëpunimit, parandalimi i hyrjes së produkteve dhe veprave penale; si edhe të fondeve të mbështetjes së terrorizmit në sektorin financiar ose zbulimi dhe raportimi i tyre.

Amendamentet që përmban ky projektligj janë përpiluar në pasqyrim të gjetjeve të raportit “Moneyval”, në funksion të rritjes së efektivitetit dhe përputhshmërisë të sistemit në parandalimit e financimit të terrorizmit dhe zbatimit në kohë edhe me efektivitet të masave të kërkuar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së.

Relatori i projektligjit u shpreh se:” *Sfidat globale bëjnë që shteti të jetë më i përgatitur, në kuptimin e një legjislacioni më konkret, më të qartë dhe me procedura strikte për t’iu përgjigjur kriminalitetit në rritje në rang global. Nga ana tjetër, organizimi strukturor i agjencive ligjzbatuese në rastin konkret, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit të Parave apo Agjencia e Administrimit të Pasurive të Konfiskuara dhe Sekuestruara, bën që të mos mbetemi thjesht në kuadrin e programimit të disa ligjeve të bukura, por të jemi në një fazë të avancuar, sikurse e përsëriti zëvendësministri. Pra, tashmë jemi në fazën e monitorimit, ku nuk na kërkohet thjesht fjalë, por na kërkohen rezultate dhe eficiencë. Rezultatet dhe eficiencia vijnë vetëm duke përmirësuar paketën ligjore, e cila në këtë rast vjen në zbatim të rekomandimeve FATF-së, të Moneyval-it, por transponon pjesërisht edhe rekomandimet e direktivave të BE-së, sidomos të direktivës së vitit 2015. Edhe pse në fokus, kjo paketë nuk ka në vetvete përfarimin total me legjislacionin e Bashkimit European.*

Më lejoni t’ju sqaroj se vetë direktivat e Bashkimit European kanë qenë dinamike vitet e fundit. Është bërë në vitin 2015, por ka pasur një direktivë të re në maj të vitit 2018 dhe jam i bindur që përsëri do të kemi një pasurim të kësaj direktive, gjë që do të na bëjë që në vijim të kemi një transpozim të plotë të kësaj direktive, por është domosdoshmëri që ta kalojmë menjëherë këtë paketë, e cila ka mjaft risi në vetvete, jo gjëra të shpifura, por të mira, të marra nga partnerët ndërkombëtarë, nga legjislacionet e vendeve Perëndimore, tek të cilat përherë kemi gjetur atë bahçen pjellore ligjore për të marrë ligjet më të mira.

Për këtë paketë jemi konsultuar me grupe të ndryshme interesi, me shoqatën e bankave, me institucione të tjera shtetërore, me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, e cila ka një rol të rëndësishme në konsultimet për këtë paketë, por edhe në zbatimin e kësaj pakete apo edhe për aktorë të tjerë, me noterë, me grupe të tjera interesi, të cilat janë ose subjekte të zbatimit të drejtpërdrejtë të ligjit ose subjekte përfituese indirekte të të mirave të këtij ligji”

Gjatë shqyrtimit të projektligjit anëtarët e Komisionit diskutuan lidhur me nivelimin e adresimit në dispozitat e këtij projektligji të rekomandimeve të Komitetit MONEYVAL për Shqipërinë si dhe reflektimin e standarteve të vendosura në rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (FATF).

Propozuesit sqaruan anëtarët e komisionit se paketa ligjore prej 5 nismash e paraqitur për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Shqipërisë mund të konsiderohet se adreson në mënyrë tërësore mangësitë në sistemin e parandalimit të pastrimit të parave dhe rekomandimet e dhëna në raportin e Komitetit MONEYVAL për vendin tonë. Njëkohësisht me kërkesë të anëtarëve të Komisionit propozuesit paraqitën edhe një matricë të rekomandimeve të FATF-së që parashikohet të adresohen nëpërmjet ndryshimeve ligjore të propozuara.

Gjatë shqyrtimit, komisioni diskutoi në lidhje me përmbajtjen e nenit 1 të projektligjit dhe konstatoi se disa nga termat e projektligjit nuk ishin shoqëruar me përkufizimin e kuptimit të tyre ose nuk jepej një përkufizim i qartë dhe shterues. Në riformulimin e nenit 1 të projektligjit u bë përkufizimi i termave “Mjet virtual” “Kujdestar financiar”, dhe “Vigjilencë e thjeshtësuar.” (pika 25, 30, 31 e nenit 1)

Për të përcaktuar profesionet sipas rekomandimet e FATF në rrethin e subjekteve që i nënshtrohen këtij projektligji, komisioni ka miratuar riformulimin e germës “gj” të nenit 2. Subjekt të këtij projektligji ndër të tjerë janë dhe *avokatët, noterët dhe përfaqësuesit e tjerë ligjore, audituesit ligjore, kontabilistët e miratuar dhe profesionet e tjera rregulluara kur përgatisin transaksione ose kryejnë shërbime për klientët e tyre për veprimtaritë e përcaktuara në këtë ligj bazuar në rekomandimet e FATF-së.*

Në nenin 6 të projektligjit dispozita bënte referencë të drejtpërdrejtë në direktivën e BE-së në një kohë që nuk është ende pjesë e legjislacionit të brendshëm. Komisioni gjatë riformulimit të këtij neni “vigjilenca e thjeshtësuar” delegon përcaktimin e tyre më akt nënligjorë të Këshillit të Ministrave.

Bazuar në rekomandimin nr 11 të FATF-së afati i ruajtjes të të dhënave /dokumentacionit është për një periudhë 5 vjeçare. Në projektligj afati i ruajtjes së tyre ishte caktuar 10 vjet dhe nga ana e përfaqësuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit të Parave e lidhnin me faktin se dhe dokumentacioni bankar ruhet për një periudhë 10 vjeçare. (neni 11, pika 2 e nenit 13, dhe neni 18)

Ky rekomandim u reflektua në riformulimin e nenit 11, pika 2 e nenit 13 dhe neni 18 të projektligjit. Ligji lejon autoritetin përgjegjës që të kërkojë nga institucionet ruajtjen e informacionit dhe më shumë se 5 vjet.

Gjatë diskutimit për nenin 20 “deklarimet në kufi”, u riformulua bazuar në rekomandimet e MONEYVAL duke përcaktuar dhe masën e gjobave në raport me shumën në euro të padeklaruar. Në lidhje me aplikimin e gjobave për shtetasit në kufi, projektligji në nenin 28 parashikon hyrjen në fuqi më 1 janar 2020.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit, komisioni miratoi dhe riformulime të dispozitave bazuar në teknikën legjislative.

IV. RIFORMULIME DHE PROPOZIME PËR RREGULLIME NEN PËR NEN

Komisioni pasi shqyrtoi rekomandimet e Komisionit për Ekonominë dhe Financat dhe Komisionit për Sigurinë Kombëtare, u shpreh dakord me rekomandimet e paraqitura prej tyre duke i bërë pjesë të propozimeve si më poshtë:

A. Neni 1

- Pika 2 të ndryshohet si më poshtë:

“ Në fund të pikës 10 shtohen dy fjali, me këtë përmbajtje:

....Në këtë kategori përfshihen edhe individët, të cilët kanë pasur ose kanë funksione të rëndësishme në organizata ndërkombëtare, përfshirë anëtarët e familjes apo personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas kuptimit dhe rregullave të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Kjo kategori personash konsiderohen “persona të ekspozuar politikisht” deri në 3vite pas largimit nga funksioni ...”.

- Pika 4 të riformulohet si më poshtë:

“4. Në fjalinë hyrëse të pikës 12, si dhe në shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç” të kësaj pike, pas fjalëve “personi juridik”, shtohen fjalët “ose organizimi ligjor”.

- Pika 7 të riformulohet si më poshtë vijon:

“Pika 20 ndryshohet si më poshtë vijon:

20. “Vigjilencë e zgjeruar ndaj klientit” është një proces më i thellë kontrolli, përtej procedurave “Njihe klientin tënd” si dhe masave të “Vigjilencës së duhur”, që synon të krijojë sigurinë e mjaftueshme për të verifikuar dhe vlerësuar:

a) identitetin e klientit;

b) për të kuptuar dhe testuar profilin e klientit, të biznesit dhe veprimtarisë së tij lidhur me shërbimet, produktet dhe transaksionet e ofruara nga subjekti;

c) për të identifikuar informacionet me rëndësi dhe për të vlerësuar rrezikun e mundshëm për pastrim parash/financim terrorizmi, në mbështetje të vendimeve që synojnë mbrojtjen nga rreziqet financiare, rregullatore apo reputacionale, si dhe përshtatjen ndaj kërkesave ligjore.

- Në pikën 9, fjalia e parë e paragrafit 25, të riformulohet me këtë përmbajtje:

“25. “Mjet virtual” është një pasqyrim digjital i një vlere që mund të tregtohet apo të transferohet në formë digjitale, si dhe që mund të përdoret për qëllime pagesash ose investimesh, duke përfshirë por pa u kufizuar tek kriptomonedha.

- Në pikën 9 paragrafi 29 të hiqet.

- Pas pikës 29, shtohen pikat 30 dhe 31, si më poshtë:
 “30 **“kujdestar financiar”** është personi i cili është ligjërisht i autorizuar të kontrollojë dhe administrojë fonde apo pasuri të një organizimi ligjor për llogari të një pale të tretë.
 “31 **“vigjilencë e thjeshtuar”** është një tërësi masash që zbatohet nga subjektet e ligjit për vendosjen dhe monitorimin e marrëdhënies së biznesit me klientët, produktet dhe shërbimet e ofruara, të cilët paraqesin një nivel të ulët risku për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit.

B. Neni 2

- Pika 1 të riformulohet si më poshtë:

“1. Fjala hyrëse e shkronjës “gj” riformulohet me këtë përmbajtje:

“gj. avokatët, noterët dhe përfaqësuesit e tjerë ligjore, audituesit ligjore, kontabilistët e miratuar dhe profesionet e tjera rregulluara kur përgatisin transaksione ose kryejnë shërbime për klientët e tyre për veprimtaritë e mëposhtme:”

- Në pikën 5 shkronja “ll” në nënshkronjën “ii” shprehja “drejtor ose sekretar” të zëvendësohet me shprehjen “administrator” dhe nën shkronjën “iii” shprehja “kompani” të zëvendësohet me shprehjen “shoqëri tregtare”.

C. Në nenin 4, pika 2 të hiqet.

Ç. Neni 5

- Në pikën 1, shkronja “c” nëndarja “iii” termi “në mënyrë efektive” zëvendësohet me termin “në mënyrë efektive në përputhje me masat e përcaktuara në këtë nen.

D. Neni 6

- Në lidhje me pikën 1, fjalët “faktorët dhe situatat e parashikuara në aneksin II, të Direktivës (BE) 2015/849 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 20 Maj 2015” zëvendësohen me fjalët “faktorët dhe situatat e parashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave”.
- Në fund të pikës 4 sugjerojmë të shtohet shprehja “...në përputhje me nenin 4/1 të këtij ligji.
- Në pikën 5 shprehja “nuk është e lejuar” të zëvendësohet me shprehjen “nuk mund të zbatohet”.
- Pika 6 të riformulohet si më poshtë:

“Ndalohet kryerja e vigjilencës së thjeshtuar ndaj kategorive të klientëve, kur kjo vendoset nga autoriteti përgjegjës,

DH. Neni 7

- Shkronja “dh” të riformulohet si më poshtë:

“dh) për organizimet ligjore: identifikimin e themeluesit, të përfituesit, të kujdestarit ose të personit që ushtron kontroll faktik mbi to, sipas të dhënave të parashikuara në shkronjat e mësipërme, në varësi të faktit nëse është person fizik ose person juridik privat”.

E. Neni 9

- Në shkronjën “b” të pikës 1, fjala “pa vonesë” të zëvendësohet me shprehjen “menjëherë ..”.
- Pika 4 të riformulohet me këtë përmbajtje:

“Ndalohet mbështetja në palë të treta për rastet e parashikuara në këtë ligj, si dhe në rastet kjo vendoset nga autoriteti përgjegjës.”

Ë. Neni 11

- Në pikën 7 fjalët “vëmendje e veçantë” të zëvendësohen me fjalët “vigjilencë e zgjeruar”
- Në pikën 11, fjalët “për një periudhë 10 vjeçare “ zëvendësohen me fjalët “për një periudhë 5 vjeçare”

F. Neni 12

- Shkronja “e” të ndryshohet si më poshtë:

“e) Pika 5 ndryshohet me këtë përmbajtje:

5. Për rastet kur marrëdhënia korrespondente përfshin mbajtjen e llogarive transitore, subjektet duhet të sigurohen që institucioni financiar korrespondent:

a) ka ndërmarrë masat e vigjilencës së duhur për klientët që kanë akses të drejtpërdrejtë në këto llogari;

b) është në gjendje, nëse i kërkohet, të paraqesë informacionin përkatës që rrjedh nga masat e vigjilencës së duhur, nëse kërkohet nga institucioni financiar korrespondent”

G. Neni 13

Në pikën 2 që shton paragrafin 5 fjalët “për një periudhë 10 vjeçare” zëvendësohen me fjalët “për një periudhë pesë vjeçare”.

Gj. Neni 14 të hiqet.

H . Neni 15

- Pika 2 sugjerohet të ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Shkronja “ç”, e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) të zbatojnë procedura përzgjedhëse për rekrutimin e punonjësve të rinj, si dhe procedura për verifikimin e punonjësve ekzistues, të cilat parashikojnë standarde për garantimin e integritetit etik dhe moral dhe aftësive të tyre profesionale.”

- Pika 3 sugjerohet të riformulohet me këtë përmbajtje:

“Në pikën 1, pas shkronjës “dh”, shtohet shkronja “dh/1” si më poshtë:

dh/1) në përpjesëtim me natyrën e biznesit dhe madhësinë vetë e subjektit, të zbatojnë, për punonjësit e tyre të gjitha niveleve procedura të përshtatshme për raportimin e shkeljeve brenda subjektit, nëpërmjet një sistemi specifik, të pavarur dhe anonim, për sa ka lidhje me detyrimet e parashikuara në këtë ligj.”

H. Neni 16

Pas pikës 1 shtohet pika 2 si më poshtë:

“Në fund të pikës 3 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Nga ky detyrim përjashtohen transaksionet që kryhen me organet apo ndërmarrjet publike”

I . Neni 17 sugjerohet të ndryshohet me këtë përmbajtje:

Në fund të nenit 14 shtohet shprehja me këtë përmbajtje:

“... të përcaktuar nga legjislacioni i posaçëm në fuqi.”

I. Neni 18

- Pika 2 të ndryshohet si më poshtë:

“Fjalia e parë, e pikës 2, ndryshohet si më poshtë:

“Subjektet duhet të mbajnë regjistra për të dhënat, raportimet dhe dokumentacionin për transaksionet kombëtare dhe ndërkombëtare, pavarësisht nëse transaksioni është kryer në emër të klientit ose në emër të palëve të treta, së bashku me të gjithë dokumentacionin mbështetës, përfshirë dosjet e llogarive dhe korrespondencën e biznesit, për 5 vjet që nga data e kryerjes së transaksionit”.

- Pika 2 paragrafi i fundit të hiqet pasi Komisioni vendosi të ruhet afati 5 vjet siç është në nenin e ligjit ekzistues.
- Pika 3 po në këtë nen të hiqet pasi Komisioni vendosi të ruhet i njëjti afat , 5 vjet .

J. Neni 20 , ndryshohet me këtë përmbajtje:

Pas nenit 17, shtohet neni 17/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 17/1

Deklarimet në kufi

1. Çdo person, i cili hyn ose largohet në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, është i detyruar të deklarojë shumat në të holla, çdo lloj instrumenti të negociueshëm të mbajtesit, metalet ose gurët e çmuar, sendet me vlerë dhe objektet antike, duke filluar nga shuma 10 000 euro ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera, qëllimin e mbajtjes së tyre, si dhe të paraqesë dokumente justifikuese përkatëse.

2. Detyrimin për deklaram, sipas pikës 1, të këtij neni e kanë edhe përfaqësuesit e personave që hyjnë ose largohen në/nga territori i Republikës së Shqipërisë me çfarëdolloj mjeti transporti në rrugë tokësore, ajrore ose detare apo dhe nëpërmjet shërbimit postar.

3. Autoritetet doganore depozitojnë/raportojnë tek autoriteti përgjegjës, kopje të formularëve të deklarimeve, dokumentet justifikuese të paraqitura dhe të dhëna të tjera sipas rastit, si dhe të dhënat e plota për rastet e mosdeklarimeve.

4. Në rast kur autoritetet doganore kryesisht ose në bashkëpunim me strukturat kompetente të policisë së shtetit, konstatojnë mosdeklarimin sipas pikës 1 të këtij neni, paralelisht me trajtimin e rastit sipas dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, vendosin gjobë e cila për herën e parë në varësi të shumës së padeklaruar është në shumë fikse, dhe për raste të përsëritura do të përlllogaritet si përqindje ndaj vlerës së padeklaruar, si më poshtë vijon:

a. Për shumat nga 10 000 - 19 999 euro ose kundërvlerën e tyre në monedha të tjera të huaja, gjoba është në shumën 20.000 (njëzetmijë) lek për herën e parë, 10% të vlerës të padeklaruar për herën e dytë, si dhe 30% të vlerës të padeklaruar për rastet e tjera;

b. Për shumat nga 20 000 – 49 999 euro ose kundërvlerën e tyre në monedha të tjera të huaja, gjoba është në shumën 40.000(dyzetmijë)leke për herën e parë, 20% të vlerës së padeklaruar për herën e dytë, si dhe 40% të vlerës të padeklaruar për rastet e tjera;

c. Për shumat mbi 50 000 euro ose kundërvlera e tyre në monedha të tjera të huaja, gjoba është në shumën 60.000(gjashtëdhjetë mijë) lekë për herën e parë, 30% të vlerës së padeklaruar për herën e dytë, si dhe 50% të vlerës të padeklaruar për rastet e tjera.

5. Këshilli i Ministrave, nxjerr rregulla të hollësishme për mënyrën e zbatimit të këtij neni”.

K. Pas nenit 20 shtohet neni 20/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 20/1

Kudo ku janë përdorur në titull dhe në këtë nen fjalët “Zyra Qëndrore e Regjistrimit të pasurive të Paluajtshme” zëvendësohen me fjalët “Agjencia Shtetërore e Kadastrës”.

L. Neni 21

- Pika 1 sugjerojmë të ndryshohet si më poshtë:

“Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Në funksion të ruajtjes së konfidencialitetit për fushën e veprimtarisë së vet, sigurisë së personelit apo sistemeve në përdorim, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave mund të vendosë kufizime për të dhënat e kërkuara në funksion të së drejtës për informim, nëse kufizimi është e domosdoshëm dhe proporcional. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave duhet të arsyetojë kufizimin rast pas rasti.

- Pika 2 të riformulohet si më poshtë:

“Pika 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“3. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave emërohet, lirohet, ose shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat.

Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Drejtorisë përfshirë strukturën e teknologjisë së informacionit rregullohen nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen sipas parashikimeve të Kodit të Punës.

LL. Neni 23

- Në pikën 1 shkronja “b” fjalia e dytë të hiqet.
- Në fund të shkronjës “b” të shtohet paragrafi si më poshtë:

“Mbledhja, përpunimi dhe administrimi i të dhënave, iu nënshtrohet rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi.

- Në pikën 2 shprehja “organet e prokurorisë” të zëvendësohet me shprehjen “prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”.

M. Neni 24

fjalët “ministri i financave dhe ekonomisë” të zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për financat, fjalët “ministri për evropën dhe punët e jashtme” të zëvendësohet me fjalët “ministri përgjegjës për punët e jashtme”, fjalët “Ministri i Mbrojtjes” të zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për çështjet e mbrojtjes”, fjalët “Ministri i Brendshëm” të zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike” dhe fjalët “Ministri i Drejtësisë” të zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë”.

N. Neni 25

Në shkronjën “c” të pikës 2 referenca në shkronjën “gj/2” hiqet.

NJ. Neni 26

Fjalja hyrëse e pikës 1 të riformulohet si më poshtë:

“Kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e dispozitave të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe autoriteti përgjegjës vendos një ose disa masa administrative si më poshtë vijon:

O. Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Në nenin 28 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 fjalët “Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale” zëvendësohen me fjalët “Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”.

2. Shkronja “d”, e pikës 3, shfuqizohet.

P. Pas nenit 27 të shtohet një nen i ri 27/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 27/1

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të pikës 1 të nenit 6 dhe pikës 5 të nenit 17/1 të këtij ligji.

Q. Pika 2 e nenit 28 të riformulohet si më poshtë vijon:

“Përgjashtimisht, detyrimet që rrjedhin nga pika 4 shkronjat “a”, “b”, “c”, e nenit 20 të këtij ligji fillojnë të zbatohen nga data 1 janar 2020.”

Në aspektin liqior, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim: Komisioni e miratoi projektligjin në parim , nen për nen dhe në tërësi duke u shprehur dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

RELATORI

Alket HYSENI

KRYETARI

Ulsi MANJA